



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 09 Prill 2021

Nr: 213

**VENDIM**

**PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË DISA QENDRAVE TË VOTIMIT NË NDËRTESA PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, paragrafi 4, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V Ë R E N**

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor.

Në KQZ janë administruar shkresat e disa kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore Tropojë, Malësi e Madhe, Shkodër, Vau Dejës, Mirditë, Tiranë, Kamëz, Kavajë, Belsh, Ura Vajgurore, Gjirokastër, Memaliaj, Fier, Selenicë si dhe të administratorëve të autorizuar nga kryetari i bashkisë Tiranë, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjeve të 56 qendrave të votimit, nga ndërtesa publike në ndërtesa publike. Kryesisht shkak i referuar për zhvendosje në shkresat e kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore është sipërfaqja e vogël, dëmtime nga tërmeti dhe amortizim i ambjenteve duke mos plotësuar kriteret për të shërbyer për qendër votimi.

Nga verifikimi i kryer në terren nga Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, referohet thuajse e njëjta situatë sikundër kryetarët e njësive të qeverisjes vendore.



## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, paragrafi 4, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

### VENDOSA:

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore të afishojnë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, të caktuara me këtë vendim.
3. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore të rinjoftojnë menjëherë zgjedhësit, për adresën e re të qendrave të votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**



Qarku	Bashkia	Nr.	Njësia Adm	QV	Vendndodhja QV	
<b>Kukës</b>	<b>Tropojë</b>	1	Lekbibaj	0489	Shkolla "Tinka Kurti"	
<b>Shkodër</b>	<b>Malësi e Madhe</b>	2	Shkrel	0065	Shkolla Reç	
		3	Kastrat	0032	Vukpalaj, Qendra shëndetësore	
		4	Shkodër	0272	Shkolla "Dëshmorët e Prishtinës"	
	<b>Shkodër</b>	<b>Shkodër</b>	5	Shkodër	0272/1	Shkolla "Dëshmorët e Prishtinës"
			6	Shalë	0117	Shkolla e Mesme Breg Lumi
			7	Shalë	0119	Shkolla e Mesme Breg Lumi
			8	Shalë	0119/1	Shkolla e Mesme Breg Lumi
			9	Shkodër	0245	Qendra Shendetesore nr.4
			10	Shkodër	0245/1	Qendra Shendetesore nr.4
			11	Shkodër	0299	Shkolla 9-vjecare "Salo Halili"
			12	Shkodër	0299/1	Shkolla 9-vjecare "Salo Halili"
			13	Shkodër	0294	Shkolla 9-vejqare "Ndre Mjeda"
			14	Shkodër	0294/1	Shkolla 9-vejqare "Ndre Mjeda"
			15	Shkodër	0304	Ambulanca Dudas
	<b>Vau Dejës</b>	<b>Vau Dejës</b>	16	Bushat	0153	Shkolla "Prekë Cali"
			17	Vau Dejës	0181	Shkolla Mjedë
	<b>Lezhë</b>	<b>Mirditë</b>	18	Fan	0787	Zall Xhuxhë, Shkolla e Mesme
19			Rrëshen	0824	Shkolla 9-vjeçare, Ndërfanë	
<b>Tiranë</b>	<b>Tiranë</b>	20	Nj.Adm 5	1851	Kopështi nr.45	
		21	Nj.Adm 5	1851/1	Kopështi nr.45	
		22	Ndroq	2090	Shkolla 9-vjeçare "Ura Beshirit"	
		23	Ndroq	2090/2	Lagja e Re, shkolla 9-vjeçare	
		24	Nj.Adm 9	1960	Qendra Sociale Don Bosko	
		25	Nj.Adm 9	1960/1	Qendra Sociale Don Bosko	
		26	Nj.Adm 9	1960/2	Qendra Sociale Don Bosko	
		27	Nj.Adm 9	1960/3	Qendra Sociale Don Bosko	
		28	Nj.Adm 9	1963	Qendra Sociale Don Bosko	
		29	Nj.Adm 9	1963/1	Qendra Sociale Don Bosko	
		30	Nj.Adm 9	1963/2	Qendra Sociale Don Bosko	
		31	Nj.Adm 9	1963/3	Qendra Sociale Don Bosko	
		32	Nj.Adm 9	1963/4	Qendra Sociale Don Bosko	
		33	Nj.Adm 9	1963/5	Qendra Sociale Don Bosko	
		34	Nj.Adm 9	1961	Qendra formimi profesional	
		35	Nj.Adm 9	1961/1	Qendra formimi profesional	
		36	Nj.Adm 9	1961/2	Qendra formimi profesional	
		<b>Kamëz</b>	<b>Kamëz</b>	37	Kamëz	2046
	38			Kamëz	2046/1	Kopështi "Lidhja e Prizrenit"
	39			Kamëz	2046/2	Kopështi "Lidhja e Prizrenit"
	40			Kamëz	2046/3	Kopështi "Lidhja e Prizrenit"
	<b>Kavajë</b>	<b>Kavajë</b>	41	Kavajë	2191	Shkolla e Mesme "26 Marsi"
			42	Kavajë	2192	Shkolla e Mesme "26 Marsi"
			43	Kavajë	2179	Ish Poliklinika, Kavajë
			44	Kavajë	2180	Ish Poliklinika, Kavajë
45			Kavajë	2168/1	Çerdhja e qytetit Kavajë	
<b>Elbasan</b>	<b>Belsh</b>	46	Fierzë	2567	Kopështi i Fëmijëve	
		47	Kajan	2580	Kopështi i Fëmijëve	
		48	Rrasë	2587	Rrasë, Shkolla 9-vjecare	
<b>Berat</b>	<b>Ura Vajgurore</b>	49	Kuç	3472	Kopështi i Fëmijëve Kuç	
		50	Arrëz	3477	Kopështi i Fëmijëve Arrëz	
<b>Gjirokastrë</b>	<b>Gjirokastrë</b>	51	Gjirokastrë	4248	Shkolla "Koto Hoxhi"	
	<b>Memaliaj</b>	52	Memaliaj	4366	Kopështi nr.1	
<b>Fier</b>	<b>Fier</b>	53	Fier	2992	Shkolla 9-vjeçare "Kristaq Shtëmbari"	
		54	Fier	2992/1	Shkolla 9-vjeçare "Kristaq Shtëmbari"	
<b>Vlorë</b>	<b>Selenicë</b>	55	Kotë	4611	Qendër Shëndetësore Mavrovë	
		56	Vllahinë	4551	Qendra Shëndetësore Mallkeq	